



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt Blerje Pjesë Këmbimi

I mbajtur sot në datë 13.03.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje Pjesë Këmbimi**” me fondi limit 31,114,553.34 (tridhjetë e një milion e njëqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre pikë tridhjetë e katër) lekë pa tvsh.

323,840 (treqind e njëzet e tremijë e tetëqind e dyzet) euro pa tvsh.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 13.03.2026 është **96.08**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me të njëjtën lloj mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori vetëm ndryshon mënyra e aplikimit në rrugë.

Së dyti, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, nisur nga kompleksiteti i shërbimeve që nevojiten, të cilët duhet të ndiqen në vazhdimësi është e nevojshme që shërbimet të kryhen nga një operator ekonomik dhe specialistët e tij. Ndryshimi i personelit të specializuar nga operatorë të ndryshëm ekonomik, si rrjedhim i hapjes së mini konkursit do të sillte konfuzion dhe problematika në funksionimin dhe ndjekjen e linjës së shërbimeve për impiantin.

Së treti, theksojmë se marrëveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të percaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK-ja nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshëm për pjesëmarrjen e tyre në minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit të tyre. Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështim në furnizim, duke patur impakt direkt në veprimtarinë e AK-së.

Si përfundim, me qëllim garantimin e furnizimit në afatet kohore të percaktuara, MK me një OE të vetëm fitues do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të percaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT